



Dalës-lazna

Nr. 1-79

Br.

OBILIQ-OBILIĆ

Data 22.05.2019

Datum



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI²⁰, mbledhja e 6) me dt.30.05.2019 (e enjte) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsytimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit financiar të Ekzekutivit Janar – Mars 2019
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Komunën e Obiliqit, Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2018
5. Kërkesa e MAPL-së, për rishqyrtimin e vendimeve të Kuvendit komunal
6. Shqyrtimi i kërkesës nga Drejtoria e bujqësisë dhe zhvillimit rural, për caktimin e vendgjahut
7. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit, DKA-së, për formimin e dy Komisioneve:
 - a) Komisioni për ndarjen e kompenzimit të aktiviteteve jashtëshkollore
 - b) Komisioni për Ankesa për ndarjen e kompenzimeve të aktiviteteve jashtëshkollore
8. Shqyrtimi i kërkesës së DSHMS-së për objektin AMF në Milloshevë
9. Shqyrtimi i kërkesave
10. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri



Dalës-Izlazna

Nr. 1-80
Br.

Data 22.05.2019
Datum

OBILIQ-OBILIQ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.18.4.2019, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena (AAK), Enver Gashi (AAK), Florije Jashari (AAK), Shaip Paloja (LDK), Linda Sadiku (LDK), Fatmir Bektashi (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Lulzim Sadiku (PDK), Hysni Mjeku (PDK), Aziz Bici (LVV), Nora Preniqi (LB), Armend Rushiti (LB), Nazmi Gashi (Nisma), Dragan Dancetovic (SL) dhe Slavisa Spasic (SLS).

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Ibush Mjekiqi, Nënkryetar i Komunës, Naim Miftari, UD-së drejtorit të Ad. së përgjithshme, Zarife Behluli, drejtoreshë e DEFZH-së, Fitore Hashani, drejtoreshë e DMM-së, Arben Berisha, drejtor i DPUKP-së, përf. e OSBE-së, përf. e KFOR-it, përf. i IZHL-së, dhe përf. i KDI-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës, për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës
4. Formimi i Komisioneve, sipas vendimit të Qeverisë nr.07/96, të dt.02.4.2019 (Plotësimi dhe Ndryshimi i Komisioneve)
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

Burim Gërguri – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës dhe me rekomandimet e KPF-së, duke propozuar që të ndryshohet dhe plotësohet rendi i ditës, ashtu që në pikën e 4, të jetë: " Nisma e Kryetarit të Komunës, për bashkëpunim ndërkomunal" ndërsa në pikën e 5 të jetë: "Shqyrtimi i raportit 3 mujor financiar i Ekzekutivit të Komunës".

Aziz Bici – Unë jam kundër këtij rendi të ditës sepse është voluminoz dhe neve, materialet na kanë ardhë me 10 prill, 11 prill, 15 prill, 16 prill, 16 prill, 17 prill dhe 17 prill. Pra, neve kështu na vijnë materialet dhe kjo nuk është hera e parë. Pyetja ime për kryesuesin dhe anëtarët e Kuvendit është se qysh ne mund ta japim kontributin e duhur për të gjitha këto pika të rendit të ditës.

Lulzim Sadiku – Vërtetë, e pashë gjithë renditjen dhe mendoj se kolegu ka të drejtë sepse materiali ka ardhë i ndarë. Propozoj që të hiqet nga rendi i ditës shqyrtimi i raportit 3 mujor financiar, pasi që nuk votohet në mënyrë që ta bëjmë një analizë në mbledhjen e ardhshme dhe të jetë rendi i ditës me 7 pika.

Burim Gërguri – Ideja ka qenë që të informohemi sa më shumë me material dhe për këtë arsye juve, ju ka ardhë shumë material për këtë mbledhje.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota “Për” dhe 1 votë “Abstenim” e aprovuan rendin e ditës, me ndryshimet dhe plotësimet e cekura më lartë.

Pika e parë e rendit të ditës

Mungoi: Fatos Kurshumlija, Qëndresa Dubova, Xhezide Dragusha, me leje, ndërsa Samire Berisha dhe Agon Mjekiqi pa leje.

Pika e dytë e rendit të ditës

Aprovohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

Pika e tretë e rendit të ditës

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën e Kryetarit të Komunës, për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës. Tash, e kemi formimin e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës, në të cilin Komision duhet të jetë zyrtarja ligjore Drita Hashani.

Lulzim Sadiku – Propozon z.Hysni Mjeku, për anëtar të Komisionit.

Enver Gashi – Propozon z.Labinot Mirena.

Fatmir Bekteshi – Propozon z.Shaip Paloja.

Kryetari – propozon znj.Zarife Behluli.

Lulzim Sadiku – Propozon z.Aziz Bici.

Slavisa Spasic – Propozon z.Dragan Dancetovic.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht morën këtë:

V E N D I M

Formohet Komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës, me këtë përbërje:

- 1. Drita Hashani, Kryetare**
- 2. Hysni Mjeku, anëtar**
- 3. Labinot Mirena, anëtar**
- 4. Sahip Paloja, anëtar**
- 5. Zarife Behluli, anëtare**
- 6. Aziz Bici, anëtar**
- 7. Dragan Dancetovic, anëtar**

Burim Gërguri – Tani, kemi hudhjen në votim për dhënien në diskutim publik të Draft Statutit të Komunës së Obiliqit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht morën këtë:

V E N D I M

Për

Dhënien në diskutim publik të ndryshim plotësimit të Draft Statutit të Komunës së Obiliqit.

Pika e 4 e rendit të ditës

Burim Gërguri – Paraqet Nismën e Kryetarit të Komunës, për bashkëpunim ndërkomunal në mes të Komunës së Obiliqit, Drenasit, Skënderajit dhe Vushtrrisë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota “Për” morën këtë:

V E N D I M

Miratohet Nisma e Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.-II-292, të dt.12.04.2019, për të hy në bashkëpunim ndërkomunal.

Pika e 5 e rendit të ditës

Burim Gërguri – Paraqet Formimin e Komisioneve, sipas vendimit të Qeverisë nr.07/96, të dt.02.4.2019 (Plotësimi dhe Ndryshimi i Komisioneve). Ju njoftoj se Propozim vendimi ka qenë i vitit 2016 dhe duke marrë parasysh se kërkesat për strehim kanë qenë të mëdha si në atë kohë po ashtu, edhe në këtë kohë iniciativa ka qenë e Kryetarit të Komunës, që t’ju ndryshohet destinimi i atyre banesave, Hade dhe Hade 2 si dhe njësive të bizneseve. Komisionet janë formuar, por për shkak të mungesës në vazhdimësi të

anëtarëve të Ministrisë, unë si anëtar i atij Komisioni në bashkëpunim me Kryetarin kam kërkuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që në mbledhjen e radhës të Qeverisë të bëhet plotësim ndryshimi, i Komisionit. Pra, kemi kërkuar që Komisionet të jenë nga Komuna e Obiliqit dhe të trajtohen banesat, të përjashtohen 3 njësitë e zgjedhura me vendim, apo të privatizuar si i thojnë ata dhe 1 lokal. Ndërsa, objektet tjera, të trajtohen sipas ligjeve dhe Udhëzimeve administrative. Është me rëndësi se ky plotësim ndryshim ka kaluar dhe tash Komisionet i formon Kuvendi komunal. Këto banesa janë me karakter të përkohshëm sipas Udhëzimeve administrative.

Lulzim Sadiku – Propozoj që në Komisionin për 50 %, të Shoqatave të dalura nga lufta mos të jetë prej 5 anëtarëve, por të jetë prej 7 anëtarëve. Kërkoj që në kuadër të 3 shoqatave mund të jetë vetëm një përfaqësues i shoqatës të invalidëve të luftës, të jetë edhe përfaqësuesi i veteranëve të luftës dhe përfaqësuesi i shoqatës së dëshmorëve të luftës. Te Komisioni për rastet sociale, kërkoj të rritet numri i anëtarëve prej 5 në 7 anëtarë, të jetë dikush nga Komisioni që në fakt janë përfaqësues tjerë, e jo të caktohet Komisioni ende pa u bërë propozimi. Unë nuk u pajtova me Komisionin e dytë kur ende emrat pa i përmendë delë përbërja e Komisionit si Ibushi, Fatmiri, Labinoti etj. Kërkoj të votohet se a do të jenë 5 ose 7 anëtarë, të jenë 3 përfaqësues të shoqatave të dalura nga lufta dhe të vazhdojmë më tutje.

Burim Gërguri – Sqaron se këtu, fjala është vetëm për plotësimin dhe ndryshimin e Komisionit dhe numri i anëtarëve të Komisionit është 5, i caktuar me vendim të Qeverisë. Sa i përket shoqatave të dalura nga lufta z.Arif Krasniqi, është i autorizuar me dokument si përfaqësues i 3 shoqatave të dalura nga lufta në vitin 2016.

Aziz Bici – Te pika 2.1 dhe 2.2 e vendimit thuhet 50 %, të njëjste banesore destinohen për qëllime të zgjidhjeve të banimit të familjeve, që janë raste sociale dhe 50 %, të njëjste banesore për zgjidhjen e nevojave të banimit të kategorive të dalura nga lufta të UÇK-së, familjeve të dëshmorëve, veteranëve, viktimave të dhunës seksuale dhe personave tjerë, me nevoja të veçanta nga këto kategori. Unë kisha thënë që të mos ndahet 50 me 50, dhe se besoj që keni informacion paraprakisht edhe si Kryetar dhe si kryesues, por edhe si Komisione, se si do të jetë nevoja e ndarjes së këtyre banesave. Propozimi im është te anëtarët e Komisionit, në rast se flitet për përfaqësues që nuk janë prezentë këtu, atëherë të kërkohet nga shoqatat e dalura nga lufta që ata vetë ti japin propozimet sepse prej vitit 2016 e deri më sot janë 3 vite. Për këtë arsye unë mendoj që mos të vendosen anëtarët e përfaqësuesve të shoqatave pa i deleguar ata.

Burim Gërguri – Unë e falenderoj ish Kryeministrin Mustafa, dhe Kryeministrin Haradinaj në atë kohë që neve, na kanë bërë një zgjidhje. Me këtë vendim të plotësim ndryshimit si dhe me vendimet e para ne do ta zgjidhim problemin për një pjesë të madhe të rasteve sociale, por edhe për katëgotë e dalura nga lufta dhe shtresat tjera. Vendimi 50 %, me 50 % është nga Qeveria dhe ne s'mund ta ndërrojmë. Besoj se kjo punë ka me shkue në transparencën më të madhe të mundshme të Komisionit, të shoqërisë civile dhe qytetarëve tjerë prezentë.

Armend Rushiti – Edhe unë e përkrahu vendimin e Kryeministrit se tash banesat duhet të menaxhohen nga Komuna e Obiliqit, por Komisionet janë përafërsisht të njëjta dhe mendoj se në Komisionin e parë duhet të përfshihet dikush nga opozita. Po ashtu, z.Arif Krasniqi, duhet me letër ta sjellë dëshminë se e ka pëlqimin prej 3 shoqatave, me qenë legjitim sepse nëse ky emër është para 3 viteve dhe 3 vite janë shumë. Mirëpo, gjithsesi në Komisionin e parë duhet të përfshihet edhe një përfaqësues nga opozita dhe propozoj që në Komisionin e parë të jetë z.Lulzim Sadiku.

Nazmi Gashi – Njëherë, është mirë të formohet një Komision për vlerësim të përgjithshëm se a janë të demoluara banesat, si ka kaluar historiku i tyre deri më tani, në mënyrë që t'ju japim një pasqyrë reale Komisioneve, që pastaj kanë me veprue.

Linda Sadiku – Pyetja ime është se a do të kenë prioritet edhe nënat vetëushqyese, të cilat jetojnë në kushte mjaft të rënda ekonomike, ku sipas informacioneve të shumta dhe të dhënave në zyren për barazi gjinore ka kërkesa të shumta për strehim. Prandaj, kërkoj që edhe për ato të bëhet ndonjë zgjidhje dhe besoj se edhe kolegët tjerë, do të pajtohen me propozimin tim.

Burim Gërguri – Propozim shumë interesantë ishte dhe besoj se Komisioni do ti shqyrtoj rastet.

Lulzim Sadiku – Unë kërkova të rritet numri i anëtarëve të Komisionit dhe nuk besoj se MAPL, do të kundërshtoj rritjen e numrit të anëtarëve të Komisionit.

Kryetari – Besoj se ky është një fillim i një pune jashtëzakonisht të madhe dhe të gjitha aktet ligjore që u përmendën duhet të trajtohen veç e veç për të gjitha kategoritë. Po ashtu, kishte me qenë mirë që Komisionet të jenë sa më funksionale me punue në vazhdimësi, e jo vetëm të formohen si Komisione. Pajtohem me parafolësit te kategoria e dalur nga lufta të plotësohet me një anëtar nga familjet e dëshmorëve dhe një nga veteranët, por kam me u mundue me i kërkue emrat e tyre sa më shpejtë që me qenë sa më aktiv dhe me i fillue procedurat.

Aziz Bici – Edhe unë e përkrahu që të mbeten nga një përfaqësues të organizatave të dalura nga lufta. Por, prapë them se z.Arif Krasniqin, le ta delegojnë organizata e invalidëve, përndryshe mos thoni se Azizi po punon pas shpine sepse unë jam i sigurtë se ka bazë ligjore vendimi edhe bëjmë gabim, prandaj ai le ta marrë konfirmimin prej tyre dhe sigurisht se është i mirëseardhur. Mendoj se është edhe në interesin tuaj që këto Komisione, të jenë funksionale dhe ndarja të bëhet sa më e mirë.

Burim Gërguri – Ne tash, s'mund të humbim kohë me u marrë me çështjen e Komisioneve sepse neve na e ka dhënë një mandat Qeveria, që duhet me fillue punën sa më shpejtë. Mirëpo, besoj se kemi me krye punën më të mirë të mundshme.

Kryetari – Te Komisioni i kategorive të dalura nga lufta kërkohet edhe nga veteranët me nënshkrim, nga familjet e dëshmorëve me nënshkrim dhe nga invalidët me nënshkrim të shoqatave.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 17 vota "Për" u pajtuan që Komisioni të jetë në përbërje prej 7 anëtarëve.

Burim Gërguri – Atëherë e hudhi në votim propozimin e parë për formimin e Komisionit për zgjidhjen e përfituesve të banimit për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, dëshmorët, veteranët, viktimat e dhunës seksuale dhe personat me nevoja të veçanta.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota "Për" 3 vota "Kundër" dhe 2 vota "Abstenim" morën këtë:

V E N D I M

Themelohet Komisioni për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim për kategoritë e dala nga lufta të UÇK-së, familje të dëshmorëve, veteranëve, viktimave të dhunës seksuale, invalidëve të luftës, dhe personave tjerë me nevoja të veçanta nga këto kategori me këtë përbërje:

1. **Ibush Mjekiqi**, NënKryetar Komune dhe U.D. i DSHMS, kryesues i Komisionit
2. **Fatmir Bekteshi**, anëtar i Kuvendit komunal
3. **Labinot Mirena**, anëtar i Kuvendit komunal
4. **Zelushe Kelmendi**, Qendra Rinore - Obiliq
5. **Përfaqësues i familjeve të dëshmorëve SHFD/Obiliq**
6. **Përfaqësues i Shoqatës së Veteranëve, OVL-UÇK-së, Obiliq**
7. **Përfaqësues i Shoqatës së Invalidëve, SHIL-UÇK-së/Obiliq**

Aziz Bici – Duhet të keni parasysh se herën e parë para votimit ke thënë të merret konfirmimi për z.Arif Krasniqi, ndërsa kur e hudhe në votim nuk e ke thënë të merret konfirmimi.

Burim Gërguri – Konfirmimin do ta marrim për 3 kategoritë e dalura nga lufta, ashtu u morëm vesh. Tash, e hudhi në votim formimin e Komisionit për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim për familjet që janë raste sociale për banim social

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota "Për" 3 vota "Kundër" dhe 4 vota "Abstenim" morën këtë:

V E N D I M

Themelohet Komisioni për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim për familjet që janë raste sociale me këtë përbërje:

1. **Naim Miftari**, drejtori i DSHPE-së, kryesues i Komisionit

2. **Ibush Mjekiqi**, Nënkryetar Komune dhe U.D. i DSHMS, anëtar
3. **Fatmir Bekteshi**, anëtar i Kuvendit, anëtar
4. **Labinot Mirena**, anëtar i Kuvendit, anëtar
5. **Eljesa Terbunja**, Kryetar i shoqatës së Handikos-it, anëtar

Pika e 6 e rendit të ditës

Burim Gërguri – Ju njoftoj se në mbledhjen e KPF-së, i kemi pasë 3 kërkesa, të cilat i kemi rekomandue në Ekzekutiv, që të na vijnë me një përgjegje në KPF-në e radhës, pastaj kalohet në Kuvendin komunal. Në ndërkohë na ka ardhë edhe një kërkesë nga DSHPE-ja, për daljen në diskutim publik të Draft Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike dhe dhënien në diskutim publik të Planit Komunal të veprimit për eficiencën e energjisë.

Nazmi Gashi – Kërkon që mos të vonohen proceset dhe të votohet menjëherë.

Armend Rushiti – Pyeti se kush e subvencionon Draft Rregulloren për koston më të ulët të energjisë Qeveria, apo Komuna.

Burim Gërguri – Përgjegjet në bazë të ligjit janë ndarë 300,000 €, në këtë vit për subvencionim të energjisë, do të thotë kuotën për çmimin më të ulët do ta përcaktoj zyra e rregullatorit të energjisë. Kjo Rregullore delë për herë të parë, që është risi dhe ne do ti japim vizën për dalje në diskutim publik.

Lulzim Sadiku – Pajtohem që Draft Rregullorja të delë në diskutim publik edhe pse s'ka kalue përmes KPF-së, në mënyrë që mos të vonohemi. Ne kemi qenë në një Komision të formuar nga Kuvendi, në mandatin e parë të Kryetarit, që kemi punue në kuadër të kësaj Rregulloreje. Këtu, ka qenë një pikë e veçantë që është folë për 5 km dhe 5 km brenda Komunës tonë, nuk i përfshin disa fshtara si Kozaricë, Shipitullë, Grabofc e Sibofc. Ne atëherë, e kemi bërë atë analizën me Kryetarin konkretisht, por më duket se prapë ka mbetë me të vjetrën.

Burim Gërguri – Sqaron se Rregullorja është derivat i ligjit dhe Ligji ka kalue në Kuvendin e Republikës së Kosovës, kështu që ne nxjerrim akte të bazuara në ligj dhe jashtë ligjit s'mund të dalim.

Kryetari – Ne do të bazohemi gjithsesi në ligjin që e trajton Obiliqin si zonë të veçantë, por në ligj është edhe mundësia e tërësisë territoriale. Nëse, ne e formojmë një grup punues Ekzekutiv dhe Kuvend, atëherë mundemi me trajtue këtë çështje, ndërsa mjete të ndara për këtë vit janë 300,000 €. Ne do të provojmë edhe nga zyra e rregullatorit dhe nga Ministria e zhvillimit ekonomik nëse, ka mundësi ndonjë lehtësim më të madh.

Aziz Bici – Edhe ne e përkrahim këtë Draft Rregullore, me kusht që të respektohen procedurat e diskutimit publik.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 15vota “Për” morën këtë:

V E N D I M

Për

Dhënien në diskutim publik të Draft Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike dhe caktimin e kuotës më të ulët për çmimin e energjisë elektrike në zonën e rrezikuar mjedisore në Komunën e Obiliqit.

Dhe

Me 14 vota “Për” morën këtë:

V E N D I M

Për

Dhënien në diskutim publik të Planit Komunal të veprimit për eficiencën e energjisë (PKVEE) 2019-2021.

Burim Gërguri – Paraqet kërkesën nga shoqata e familjeve të dëshmorëve për shfuqizimin e vendimit për emërimin e sheshit të qytetit me emrin “Adem Preniqi” dhe të njejtin ta emëroj “Sheshi i dëshmorëve”.

Po ashtu, e kemi edhe kërkesën nga familja Preniqi, për pezullim të emërimit të sheshit me emrin “Adem Preniqi” dhe të bartet emri i tij në ndonjë shesh apo institucion ashtu si e vlerësojnë anëtarët e Kuvendit komunal.

Kryetari – Unë e përkrahu kërkesën e familjeve të dëshmorëve dhe e falenderoj shumë edhe familjen Preniqi, që kanë ofruar gatishmëri për rrethanat që janë krijuar, që të hiqet emri nga sheshi. Ndërsa, juve si anëtarë të Kuvendit komunal, ju mbetet që të vendosni për çështje të mëtutjeshme.

Labinot Mirena – Deshta personalisht ta falenderoj familjen Preniqi, për këtë gjest që është për me u vlerësue nga ana e tyre. Propozoj që emri “Adem Preniqi” të bartet në pjesën ku janë duke u rrënuar banesat, që besoj se edhe aty do të jetë një shesh i mirë.

Aziz Bici – Së pari, mos me na vënë në këso pozitash, mendoj se është dashur të na dorëzohen 2 kërkesat, por si do që të jetë është dashur të shtyhet për seancën e ardhshme sepse mendoj se kjo nuk ka qenë urgjente aspak. Shpresoj të jetë hera e fundit që na vini në këso pozitash sepse nganjëherë po biejmë në pozita të ndijshme, të rënda që nuk është lehtë ti shprehim mendimet tona. Ju e dini se propozimi ynë nuk ka qenë kundër emrit “Adem Preniqi” por kemi qenë kundër procedurave, kundër asaj që edhe sot e asaj dite nuk na është ofruar se a janë respektue procedurat e debateve, apo nuk janë respektue edhe pse kërkesa jonë ka qenë me shkrim. Prandaj, këtu sikur është keqinformue familja Preniqi, prej procedurave qysh është kërkuar. Mendoj se familja nuk është dashur ta bën kërkesën, por vetë grupi i cili e ka propozue emrin e të ndjerit Preniqi, sepse do të ishte më lehtë edhe për neve dhe për familjen, mirëpo, edhe si procedurë është dashur të mbetet ashtu. Mendoj se si do që të jetë propozimi që të shfuqizohet ai vendim dhe të respektohen prapë procedurat, unë jam për atë që të votohet shfuqizimi i vendimit.

Lulzim Sadiku – Vërtetë, ka qenë një fitim shumë i madh i Komunës së Obiliqit, që sheshi është emëruar ndoshta, në shpejtësi me emrin “Adem Preniqi”. Unë konkretisht edhe ditën që është votue jam ndjerë keq dhe disa nga kolegët e mi, shokët e vjetër kam propozue atë ditë që të ndahet në 2 pjesë sepse ne kemi punuar me Adem Preniqin, e kemi familjen e tij të lidhur familjarisht dhe jemi njerëz që kemi bashkëpunue shumë afër me të. Ne kemi qenë në pozitë shumë të palakmueshme sepse vërtetë dilnim ndaj një kolegu që i ka kontributet e veta. Ne kemi kërkuar që sheshi të emërohet “Sheshi i dëshmorëve” me arsye jo pse nuk na ka ardhë keq nga familja Preniqi, në ditën që kemi votue, por pse kemi thënë se ne nuk jemi kundër asnjë emri, por më meritoret janë dëshmorët e kombit. Unë e përhëndes shumë familjen Preniqi dhe kërkoj që të bëhet ky ndryshim.

Hysni Mjeku – Unë jam kogja konsekuent në vendimet e organeve të pushtetit lokal, por edhe qëndror. Vendimet e Kuvendit komunal nuk duhet ashtu shpejtë të hudhen sepse vërtetë është analizuar bukur gjatë dhe mirë. Një gjë duhet ta dijmë edhe shoqatat e dala nga lufta se çdo kërkesë duhet të jepet me kohë dhe në afatet e caktuara. Unë po ju them sinqerisht se shoqata është vonuar skajshmërisht jo vetëm në këtë rast, por edhe kur i kemi emëruar sheshet, rrugët, lapidarët, shoqatat e dala nga lufta kanë qenë sikur mos me qenë fare këtu në Obiliq, inekzistente. Falë këtij Kuvendi, asambleistëve të mëparshëm kemi emëruar rrugë, sheshe etj. prandaj vërtetë shoqatat e dala nga lufta duhet ta luajnë rolin e vet në kontinuitet me kohën, e jo vetëm në momente të caktuara. Ne nuk guxojmë të luajmë me vendimet e institucioneve pavarësisht se a i dhembë dikujt, apo nuk i dhembë. Mirëpo, meqë familja Preniqi ka shprehë një kërkesë të tillë, që unë edhe e falenderoj publikisht familjen Preniqi, dhe i kërkoj falje nga ky Kuvend që vërtetë kemi ardhë në këtë gjendje, që nuk është dashur të jemi. Unë e njohë shumë mirë Adem Preniqin, para luftës, gjatë dhe pas luftës dhe kontributi i tij është i pa zëvendësueshëm në krahasim me gjeneratën që ka jetue dhe veprue, prandaj duhet të çmohen edhe vlerat e luftës dhe vlerat e aktivitetit politik. Unë jam pro një iniciative të tillë dhe njëkohësisht kam edhe një vërejtje për kuvendarët, që kur marrin vendime të fuqishme të jenë prapa tyre.

Shaip Paloja – Vërtetë, jemi në pozicion të vështirë për ta shfuqizue vendimin tonë që e kemi sjellë me plot vetëdije dhe fatkeqësisht nuk kemi asnjë material, as nuk e dijmë çka po shfuqizojmë, apo ndryshojmë, apo emërojmë diçka tjetër. Mendoj se paraprakisht materialin duhet ta kemi para se të marrim një vendim si Kuvend. Unë habitem pse familja Preniqi, ka ardhë në një pozicion me bënë kërkesë për shfuqizim të emrit Adem Preniqi. Edhe pse ne të gjithë kemi respekt për shoqatat e dala nga lufta dhe e dijmë gjithmonë kontributin e tyre dhe tërë jetën do t’ju jemi mirënjohës. Tash, të sjellet në pozicion një

familje, të kërkoj të shfuqizohet një emër i një aktivisti të devotshëm, është vërtetë për me u habitë. Unë nuk e di interesat e kujt janë, por unë kisha kërkuar që të na sjellet materiali dhe ne të vendosim në bazë të materialit ose mundësisht të shtyhet për seancën tjetër. Besoj se kështu, do të kontribuojmë që mos të ketë keqkuptime dhe që Komuna jonë të zhvillohet në frymën që neve, na takon.

Armend Rushiti – Edhe unë e respektoj vendimin e familjes Preniqi, dhe propozoj që emri i tij të lartësohet dikund në ndonjë institucion tjetër dhe tash e tutje të ndjeken procedurat dhe rregullat për emërtimin e sheshit. Normalisht e përkrahu vendimin që sheshi të quhet “Sheshi i dëshmorëve”.

Kryetari – Unë ju kuptoj në situatën në të cilën jeni, por mua më erdhi mirë fillimisht se vetë familja e ka parë situatën dhe janë para një situatë të tillë që kanë kërkuar, por në kërkesë thuhet të bartet dikund tjetër. Mua, më pëlqeu propozimi i z.Labinot, që emri i Adem Preniqit, të bartet në pjesën e re ku jemi duke rënuar dhe duke i heqë barakat që të bëhet sheshi tjetër, ndërsa, te sheshi aktual që është të bëhet sheshi “Dëshmorët e kombit”. Mbi të gjitha, e falenderoj shumë familjen Preniqi që ka kërkuar me vetë dëshirë të bartet emri në një zonë tjetër, ndërsa pjesa tjetër të emërohet “Dëshmorët e kombit”.

Burim Gërguri – E falenderoj pa masë kërkesën e familjes Preniqi, për mirëkuptim dhe është vullnet që ne duhet me respektue dhe çmue. Edhe unë jam për atë që emri Adem Preniqi, të bartet në pjesën tjetër dhe gjithsesi figura e lavdishme e dëshmorëve të kombit të aprovohet në sheshin ku janë punimet ekzistuese. Unë ju kërkoj falje për materialin në mungesë.

Aziz Bici – Unë jam për atë që të shfuqizohet vendimi dhe gjithsesi të respektohen procedurat e debateve publike. Kjo ka qenë edhe kërkesa jonë kur është propozuar që të vendoset emri i të ndjerit Adem Preniqi. Ndërsa, që të bëhet kjo qysh po kërkohet, unë ia shohë pak për të madhe z.Shaip, sepse ato shoqata që e kanë sjellë këtë pushtet deri këtu, ato shoqata ju kanë sjellë juve deri këtu për me i marrë këto vendime. Unë e di se çdoherë në akademi përkujtimore, në vizita keni qenë së bashku dhe tash të keni këso kontradita, këtu diçka në terezi nuk është. Prandaj, unë them që të shtyhet për seancën e ardhshme, le të vjen rendi i ditës me kohë, që ta japim kontributin në mënyrë që askush të mos jetë mangut rreth kontributit dhe mos të merren vendime prapë të gabueshme, që në të ardhmen gjeneratat të na akuzojnë.

Nazmi Gashi – Kërkoj të zhvillohemi si Komunë, sepse kemi me pasë rrugë e sheshe dhe të gjithë besoj se do ta gjejnë veten aty. Uroj që mos të kemi këso probleme më dhe çfarëdo vendimi që kalon nëse, veç janë pajtuar të gjithë ne do ta votojmë.

Lulzim Sadiku – Unë jam për atë që të bëhet një analizë e mirë sepse Ademi ka qenë një mësimdhënës shumë i ri dhe jam pro dhe qëndroj prapa fjalës, do të thotë të bëhet një analizë, të ndiqen procedurat dhe të mose vijmë në situatën në të cilën jemi tash, apo që kemi qenë para 3 muajve. Ndoshta, është ideja më e mirë që një shkollë të emërohet me emrin e tij sepse ai ka qenë një mësimdhënës për një kohë shumë të gjatë dhe të vështirë kur atëherë ka punuar ai. Pra, unë jam pro kërkesës së familjes Preniqi, por vetëm të mos ngutemi dhe ti ndjekum procedurat.

Shaip Paloja – Vërtetë, thashë se ne patëm mungesë të materialit, por pas sqarimeve të Kryetarit e kuptova që kërkohet një bartje dhe nëse, nxjerret një vendim i saktë për bartjen e emrit edhe ne do ti kontribuojmë qetësisë në Komunën tonë dhe do ta përkrahim.

Arben Berisha – Unë i kam 2 vendimet dhe të 2 vendimet janë shpallje me interes të përgjithshëm që e mundëson emërtimin nga Kuvendi komunal në bazë të Udhëzimit administrativ dhe nuk ka shkelje. Mirëpo, një numër kadastral duhet me skicue, që me heqë dhe këtu fjala është për restorant KEK-un, që delë jashtë rr.”Ferid Curri” ndërsa të gjitha tjerat janë në harmonizim me ligjin.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 9 vota “Për” dhe 1 votë “Kundër” u pajtuan që të shqyrtohet kërkesa e shoqatave të dala nga lufta dhe kërkesa e familjes Preniqi, si dhe të merret vendim meritor sot.

Burim Gërguri – Tash, e hudhi në votim çështjen që emri i sheshit “Adem Preniqi” të bartet në zonën me interes të përgjithshëm përballë banesave të KEK-ut, në sheshin ekzistues dhe ti hapet rruga e emërtimit të ri të sheshit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota "Për" 1 votë "Kundër" dhe 2 vota "Abstenim" morën këtë:

V E N D I M

Emërohet Sheshi i ri i qytetit në rrugën "Hasan Prishtina" me emrin e veprimtarit "Adem Preniqi" (Vendimi I-166, i dt.30.10.2018, për emërtim bartet te sheshi i ri).

Burim Gërguri – Tash, e hudhi në votim emërimin e sheshit të qytetit sipas kërkesës së përfaqësuesve të familjeve të dëshmorëve me emrin "Dëshmorët e kombit".

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota "Për" morën këtë:

V E N D I M

Emërohet Sheshi i ri në qendër të qytetit në rrugën "Hasan Prishtina" me emrin "Dëshmorët e kombit".

Pika e 7 e rendit të ditës

Hysni Mjeku – Pyeti se kur pritet asfaltimi i rrugëve, të cilat janë shtruar me zhavorr.

Kryetari – Përgjegjet se janë në proces dhe besoj se gjatë këtij muaji gjithsesi duhet të përmbyllen.

Linda Sadiku – Pyetja ime është për Drejtorinë e Arsimit. Që nga momenti i marrjes së vendimit për zëvendësimin e orëve të humbura mësimore të grevës së përgjithshme në Arsim, që ndodhi në janar pse në disa shkolla është punuar gjatë pushimit pranveror, ndërsa në disa shkolla nuk është punuar. Kjo vazhdon edhe tash kur orët është dashur të zëvendësohen të shtunave, në disa shkolla punohet, por në disa nuk punohet. Pastaj, ndodhë që në një shkollë të njejtë një klasë punon, ndërsa një klasë nuk punon ose nxënësit nuk vijnë fare, mësimdhënësit vijnë ose e kundërta. Pra, pse kjo laramani është aq aktuale.

Kryetari – Përgjegjet se drejtori i Arsimit më tha se janë duke punuar në nivel të regjionit për me zgjidhë këtë problem. Është e vërtetë se nga greva atëherë, është një çrregullim total në nivelin arsimor, por shpresojmë që sa më shpejtë në këtë rast ta bëjë zgjidhjen Ministria me sindikatën. Sa i përket zëvendësimit të orëve, e di që rëndon drejtpërdrejtë mbi Komunat, në këtë rast mbi Drejtoritë e Arsimit. Është e vërtetë se në disa shkolla është punuar, e në disa jo, por të gjitha orët që janë zëvendësue, këta do ta përmbyllin më heret.

Arben Berisha – Te banesat ekzistuese te sheshi që jemi në shpronësim kemi probleme me gjendjen ekzistuese dhe gjendjen me dokumentacion, do të thotë në kontrata kanë m² më pak, ndërsa në gjendjen faktike delë gati dyfishi i m². Unë kërkoj një mbështetje nga ju sepse ne tash kemi hy në fazën e shpronësimit dhe kemi bërë shkresë në Ministrinë e financave, për vlerësim. Ministria e financave, e ka sjellë elaboratin komplet, e ka përcaktue edhe çmimin, por tash jemi në këtë dilemë sepse ne si Drejtori nuk mund të marrim asnjë hap nëse, ju nuk na mbështetni. Ju, tash është me rëndësi se a jeni për me na përkrahë neve si organ shpronësues, që ne të marrim vendim dhe të paguajmë për m² që janë faktike sepse nëse, shkojmë me dokumentacion nuk janë metrat reale.

Labint Mirena – Pyeti se si ka ardhë deri te kjo, nëse e ka pasë shtëpinë 30 m² tash ai e paska zgjerue sepse paska ndërtoe diçka më shumë aty dhe ne s'mund të paguajmë jashtë ligjit.

Arben Berisha – Përgjegjet se ndërtesa nuk zgjerohet, janë ato metra që janë psh aty është banim dy katëshe, me dokument i ka 37 m² ndërsa gjendjen faktike dhe matjet që i kemi bërë ne dalin dikund 70 m². Kërkesa ime kishte me qenë me u thirrë në bazë të gjendjes faktike, nëse ju na përkrahni.

Burim Gërguri – Meqenëse, nuk kemi material propozoj ta shtyejmë për mbledhjen e radhës këtë çështje.

Arben Berisha – Material tjetër s'ka veç mund ti përsërisë këto fjalë.

Nazmi Gashi – Shpjegon se objekti për të cilin po flitet në bazë të projektit psh i ka 250 m² banim dhe tash ato 250 m² ne kemi me i pague sepse është gjendje faktike. Tash, aty janë 2 bashkëbanorë dhe njëri ia ka falë tjetrit banesën, ky i ka bërë 70 m² dhe tjetri nuk ekziston më, do të thotë se brenda objektit ne kemi me i pague 250 m² banim.

Arben Berisha – Sqaron se nuk është punë projekti, por ne po dyshojmë se në vitet e hershme kanë shenuë më pak metra për me ju ikë disa tatimeve.

Kryetari – Mua, më pëlqej kjo që e tha z.Nazmi, dhe vërtetë është për me u habitë se ndoshta në kontratë i ka 50 m² të regjistruara këtu, dhe ai objekt është i vjetër e dijmë të gjithë se s'ka pasë mundësi zgjerimi, ndërsa gjendja faktike është 70 m². Unë në këtë rast pajtohem me kryesuesin dhe me juve që të keni material më shumë dhe në mbledhjen e radhës ta bëjmë një elaborat të mirëfilltë sepse mund të kemi telashe edhe me Gjykatë. Ne duhet të dalim me një vendim që të paguajmë sipas gjendjes faktike, apo të paguajmë sipas kontratës, ndërsa pjesa tjetër të rregullohet me Gjykatë. Mbi të gjitha ne duhet ta kemi elaboratin sepse çështja e banimit është pak situatë e ndjeshme.

Hysni Mjeku – I nderuari drejtor është një thënie latine “Fjalët i merrë era, ndërsa shenimet mbeten” kërkoj të jepem shenimet e sakta në m² në mënyrë që të bazohemi në gjendjen faktike.

Arben Berisha - Unë për këtë arsye po e kërkoj mbështetjen prej juve për gjendjen faktike.

Aziz Bici – Sikur drejtori mos të thoshte se edhe në mbledhjen e ardhshme nuk do të keni material, unë nuk do ta kisha marrë fjalën. Elaboratin që e përmendi Kryetari, ne e presim atë dhe këta le ta bëjnë një skicë, është Urbanizmi dhe kretjtë çka është në kontest le të na sjellin neve, si material në mënyrë që të dijmë se çka po votojmë.

Lulzim Sadiku – Unë prej përvojës së fundit, kemi pasë një rast korporata e quajtur atëherë, KEK-u tash nuk ua ka numrue banjot, nuk ua ka numrue koridoret, por vetëm dhomat e fjetjes. Unë po flas për periudhën 71-76, do të thotë se në mbledhjen e ardhshme Kryetar unë do të mundohem me sigurue këtë vendim që i ka numrue vetëm pjesët e banimit dhomat e fjetjes dhe kuzhinën. E kemi pasë një kontest në Gjykatë, banesa me dokument është 56 m², ndërsa njeriu brenda saj qëndron me 72 m² dhe është kërkuar përmes arkivave të KEK-ut, që me siguri se do ta sjellë atë vendim se nuk janë numrue banjot dhe koridoret si pjesë e banimit sepse i ka pasë punëtorët e vetë. Nëse, është pjesë e KEK-ut, besoj se kemi me bë një ndihmë shumë të madhe, sepse unë e di se ku është ndërtesa, por a është pronë e KEK-ut, apo nuk është nuk e di.

Avdyl Mustafa – Dua ta falënderoj Komunën e Obiliqit si edhe Kryetarin që na ka përkrahur në realizimin e aktiviteteve të reja sportive me rastin e Ditës ndërkombëtare të Romëve, 8 prillit. Desha ta njoftoj Kryetarin se projekti për vendosjen e rrjetit të kanalizimit të ri në Plemetin, në rrugën “Sokoli” ka filluar dhe jemi shumë falënderues për këtë, por mungon rrjeti i ujësjellësit. Pasi që veç po mihet për kanalizim, do ta lusja Kryetarin nëse mundet ta bëjë z zgjidhjen për vendosjen e rrjetit të ujësjellësit, që të mos mihet toka dy herë.

Kryetari – Përgjegjet se kam biseduar edhe me drejtorin e DSHPE-së, dhe këta e kanë marrë gjendjen, paraprakisht do ti bëjnë vlerësimet në atë zonë. Unë pajtohem që mos të bëhen punët 2 herë, njëherë si të hapet komplet infrastruktura nëntokësore, pastaj vjen rruga.

Fatmir Bekteshi – E kam një vërejtje të zotëruar që flet sepse në qytet e dëgjon që flet shqip, ndërsa këtu flet në gjuhën serbe, pse nuk flet shqip.

Aziz Bici - Unë e përkrahu në cilën gjuhë ai e ndjen veten më mirë edhe mund të shprehet.

Burim Gërguri - Është e drejtë ligjore e njerëzve se cilën gjuhë e dijnë të shprehen.

Mbledhja përfundoi në ora 12:25'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit komunal


Burim Gërguri